



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:137581

Datë: 14.09.2020

Numri i dokumentit: 01110361

P.nr.142/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me sekretaren juridike Shere Desku, në çështjen penale kundër të pandehurit, XH. (B.) P.,K Klinë, për shkak të veprës penale „Vjedhje e Shërbimeve” nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 6 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.Nr.970/2019, të dt. 25.06.2019, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurori i Shtetit Arben Hoti nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe të pandehurit të lartëcekur, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të dt. 11.08.2020, shpalli aktgjykimin, ndërsa me datën, 11.09.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: XH. P. i lindur me dt.... K. Klinë ku dhe jeton, nga prindërit i ati B. dhe e ëma M., i identifikuar me nr personal, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTORË

Për shkak se ekziston dyshimi i bazuar mirë se:

Nga data e pavërtetuar e gjer me datën 20.08.2017, pikërisht në objektin (lokalin) „P...” Komuna e Klinës, në cilësi të shfrytëzuesit të energjisë elektrike, në kundërshtim me Ligjin nga neni 61 me qëllim që vetes të i sjellë pasuri në mënyrë të kundërligjshme e pa autorizim të furnizuesit të autorizuar ka përdor energji elektrike, në atë mënyrë që:

Gjatë kontrollimit të bërë nga ana e komisionit të autorizuar të K...-it, të njëjtit në njehsorin elektrik nr. kanë hasur që kishte të kyqura kaset direkt në KKK përmes ndërprerësit 1-0-2 kishte anashkaluar pikën matëse, me çka në mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike, ndërsa si pasojë e kësaj të dëmtuarës K... i ka shkaktuar dëmin në vlerë qe tani e tutje duhet të jetë 1281.4 Euro.

Më këtë ekziston dyshimi i bazuar mirë se e ka kryer veprën penale: „Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314 par. 1 lidhur me par 6 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41, 50, 51,52 dhe 73 si dhe nenit 314 lidhur me par 6 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së:

G J Y K O N
DËNIM ME KUSHT

I.Të akuzuarin: XH. P., me dënim burgu në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale, pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë.

II.OBLIGOHET: I pandehuri që ti paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzet) €, si dhe 30 (tridhjetë) €, për fondin e kompensimit të viktimave të krimit, gjithsej shumen prej **50 (pesëdhjetë) €**, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur ky aktgjykim të marrë formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë .

III.UDHËZOHET: Pala e dëmtuar „K...” Distribucioni në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzë XH. (B.) P., K Klinë, për shkak të veprës penale „Vjedhje e Shërbimeve”, nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 6 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.Nr.970/2019, të dt. 25.06.2019,

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt. 11.08.2020, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Ersan Qavolli nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe i akuzuari XH.P..

Gjykata ka bërë tri ekspertiza nga Lëmia e elektroteknikës, ekspertiza e parë e bërë nga zyrtarët e K.-si- A. B. dhe A. L., me kërkesë të të pandehurit, është caktuar ekspertiza e dytë është bërë nga eksperti përkatës Ing.M. D. ndërsa ekspertiza e tretë është bërë nga eksperti M. Sh. Ing.i elektroteknikës, këto dy të fundit janë identike dhe kanë vlerësuar dhe kanë ardhur në përfundim se për periudhën 01.09.2016-20.08.2018 fakturimi real për rikthimin e humbjeve në lokalin „P....me pronar XH. P. duhet të jetë 1281,4 €uro.

Prokurori i shtetit Arben Hoti në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me qense nga ana e gjykatës na është dorëzuar kopja e ekspertizës së tretë e punuar nga profesor M.Sh. i cili në konstatimin e tij deklaroi se mbetet në plotëni me ekspertizën e ing. Eksperti M.D. ku është vlerësuar se dëmi i shkaktuar nga i pandehuri duhet të jetë 1281.4 €uro. E duke krahasuar se në dispozitivin e aktakuzës vlera e dëmit të shkaktuar ka qenë e caktuar 5.309,19 €uro.

Prokurori bënë përmirësimin e dispozitivit vetëm përkitazi në lartësinë dëmit ashtu që tani e tutje lartësia e dëmit duhet të jetë 128.4 €uro.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit gjyqësor, është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe ka shtuar se kërkoi falje dhe premtoj se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, meqë është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj dënim më të butë.

Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat e pranimin të fajësisë, pasi që ky pranim është bërë konform dispozitivave të KPRK-së, neni 248.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuar nga Prokurorja e Shtetit.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht Prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitivit të nenit 248, par.1, të KPRK-së

dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj Gjykata konform nenit 248, par.4, të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale: vjedhje e shërbimeve, nga neni 314 **par. 1 lidhur me par.6** të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri, gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, faktin se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, gjendjen e tij shëndetësore i cili është invalid i luftës, ndërsa duke pas parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethanë rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh kryerjen e veprës penale.

Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, par.1, të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur, duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, aprovoj aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, për dhënien e dënimit meritor, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Vendimi mbi shpenzimet procedurale penale apo paushallit gjyqësor u morë në bazë të nenit 450 par 1 dhe par 2 pika 2.1 dhe pika 2.6 lidhur me nenin 453 par 1 të KPPRK-së, si dhe shpenzimet për kompensim të viktimave të krimit u muar konform Qarkores për zbatimin e ligjit nr.05/L-036.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463, par.1 dhe 2, të KPRK-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave ligjore të nenit 25, par.2, 26, par. 2, 297, dhe 365 dhe 470 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
P.nr. 142/2019, me dt. 14.09.2020

Sekretare juridike
ShereDesku

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet
Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e
pranimit të njëjtë, Gjykatës së Apelit në
Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.